



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 279/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muhamet Rexha kryesues, Hasan Shala dhe Ferit Osmani anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Partia Demokratike e Ashkalinjëve të Kosovës (PDAK) dega në Ferizaj, paraqitur kundër subjektit politik Partia e Ashkalinjëve për Integrim (PAI) dega në Ferizaj, për shkak të zhvillimit të fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet Lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 25.10.2013, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e subjektit politik Partia Demokratike e Ashkalinjëve të Kosovës (PDAK) dega në Ferizaj .

Arsyetim

Me datën 18.10.2013, PDAK-ja, ka parashtruar ankesë në PZAP, në të cilën ankesë pretendon se, me datë 13.10.2013, në fshatin Dubravë , militantët e PAI-së kanë organizuar një fushatë, ku shumica nga pjesëmarrësit ishin fëmijë, andaj fëmijët i ka organizuar që të mbajnë posterat e tyre, me qëllim që ta ofendojnë PDAK-në. Parashtruesi i ankesës ka theksuar se me ligj fëmijët nuk mund të jenë pjesë e fushatave. Në cilësinë e provës, parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur një fotografi si dëshmi .

PZAP-i, në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, e informoi subjektin politik PAI me datën 16.10.2013, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 19.10.2013 deri në ora 14:00.

PZAP-i, e pranoi përgjigjen e kërkuar nga PAI-ja, sipas afatit të caktuar, dhe ka shtuar se në përgjigje të ankesës me datë 23.10.2013 PAI-ja, ka theksuar se, ankesa e parashtruar nga PDAK-ja është krejtësisht e pa bazë dhe më tutje ka shtuar se, PAI-ja ka mbajtur fushatë zgjedhore me datë 13.10.2013 në fshatin Dubravë, ku i kemi njoftuar organet përgjegjëse dhe kemi qenë në përcjellje të tyre .

Për më tepër ka theksuar , fushata është mbajtur në ambient të hapur, kryesisht në rrugët e fshatit Dubravë dhe dorë me dorë me qytetarë, ku ka pasur prezencë të fëmijëve të atij fshati dhe kjo nuk është e mundur të ndalohet pasi që ata ishin banorë të atij fshati dhe kishin dalur në rrugë për të na përshëndetur. PAI-ja nuk ka pasur për qëllim shfrytëzimin e fëmijëve dhe nuk do të ketë asnjëherë .

PZAP-i, pasi që administroi shkresat e lëndës gjeti se:

ankesa është e pabazuar

Me ankesën e parashtruar nga PDAK-ja, pretendohet se militantët e subjektit politik PAI, në fshatin Dubravë kanë organizuar një fushatë ku shumica e pjesëmarrësve ishin fëmijë, prandaj fëmijët i kanë organizuar që të mbajnë posterat e tyre të PDAK-së me qëllim të ofendimit.

PZAP-i, gjeti se pretendimet ankimore nuk qëndrojnë, ngase dëshmia e ofruar nga parashtruesi i ankesës nuk është objektive, me të cilat vihet në dyshim se është kryer një veprim i ndaluar, për arsye se nga fotografia e ofruar si provë nga PDAK-ja, shihet se është organizuar mbajtja e fushatës nga radhët e PAI-së, mirëpo pjesëmarrja e fëmijëve në fushata zgjedhore nuk është e ndaluar sipas dispozitave të LZP-së.

PZAP-i, konstatoi se një pretendim i tillë është i përgjithshëm dhe i pa qartë për tu administruar si provë relevante nga fotografia e paraqitur si dëshmi bindëse, prandaj ankesa vlerësohet si e pa bazë duke u bazuar në nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, neni 3.6 pika b), dhe në kuptim të nenit 115.1 lidhur me ankesën e lart përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia në Prishtinë

A nr. 279/2013 më datën 25.10.2013.

**Kryesuesi i Panelit
Muhamet Rexha**



Këshillë Juridike: PZAP-i nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*